



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**“UJËSJELLËS GRAMSH”SH.A**  
**NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Gramsh, më 16/06/2020

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

Data 16.06.2020

Për: Bashkimin e Operatorëve ekonomikë - “Viante Konstruksion”sh.p.k &”Euro-Alb” sh.p.k

Adresa: Lagjia “Sporti “, Gramsh & “ Lagjia “Minatori”,rruga e Spitalit,Pall.nr.22,shk.1,kati 5,Ap.15, Bulqizë.

Procedura e prokurimit: “E hapur”,me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-56168-04-14-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës:" Rikonstruksion i linjës kryesore të ujësjiellësit fshati Mashan,Njësia Administrative Kodovjat & vendosje matësash në pallatet me kollonë të brendshme qyteti Gramsh” me afat 120 ditë nga data e lidhjes së kontratës..

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike 21/04/ 2020 [Nr. 20]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

\* \* \*

1. **Shoqëria - “Kurti-07”sh.p.k**, me nr.Nipti K73814201W me vlerë të ofertës 30 237 931( tridhjetëmilionë e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një ) lekë,pa TVSH.
2. **Bashkimi Operatorëve Ekonomikë - “Beqiri”sh.p.k & “Shendelli” sh.p.k**, me nr.Nipti J98624801V & K07924803N me vlerë të ofertës 28 813 729 (njëzetë e tetë milionë e tetëqind e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë e nëntë ) lekë,pa TVSH.
3. **Bashkimi Operatorëve Ekonomikë-“Viante Konstruksion”sh.p.k & ”Euro-Alb” sh.p.k**, me nr.Nipti K47103804L & K66613407H me vlerë të ofertës 29 785 889 (njëzetë e nëntë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë )lekë,pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Operatori ekonomik - “Kurti-07”sh.p.k.,për arsyet :**

Nuk plotëson kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit,konkretisht:

- Nga verifikimet e kryera ,sipas vërtetimit Nr.T02398638 datë 08.06.2020 , ka detyrime tatimore të papaguara, në kundërshtim me nenin 45 gërma „d“ e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”,i ndryshuar, Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; përcaktuar dhe në pikën „d“ të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit ,pasi nuk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e

tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

- Nuk përmbush kriterin për punë të ngjashme pasi ka operatori për të provuar se përvojën e tij ka dorëzuar kontratën datë 15.09.2015 ,si nënkontraktor , e cila ka përfunduar më datë 28.03.2016, dhe po këtë vit mbajnë datën edhe situacionet dhe faturat tatimore të shitjes,pra punimet nuk janë kryer brenda afatit 3-vjecar të kërkuar në dokumentat e tenderit,Gjithashtu për këtë objekt nuk është dorëzuar akti i kolaudit sic kërkohet në DST.Gjithashtu për të provuar përvojën e ngjashme ka dorëzuar kontratën e datës 01.09.2017 dhe e ka shoqëruar me si situacionet dhe një faturë tatimore nr. 18 datë 28.03.2019 në vlerën 341 160 lekë , duke mos përmbushur kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit ,si dhe nuk është dorëzuar akti i kolaudit të objektit .Sa më sipër OE nuk përmbush kriterin për përvojën për punë të ngjashme me objektin e prokurimit.
- Licensa e shoqërisë NZ.7288 nuk përmban kategoritë e përcaktuara në dokumentat e tenderit :N.P-5(*Punime nentokesore*),Niveli A,N.P-12 (*Punime te inxhinjerise se mjedisit*)NiveliA,N.S.-8 (*Ndertime beton arme*),Niveli A,N.S.-10 (*Shtresa dhe mbistruktura infrast*), Niveli A,N.S.-14 (*Impiante te brendshme, elektrik*),Niveli A,N.S.-16 (*Ndertim i impiateve te ujit*),NiveliB,N.S.-18 (*Punime topogjeodezike*), Niveli A,N.S.-20 (*Shpime gjeologo-inxhinier*), Niveli A.
- Nuk plotëson nr.prej 100 punënjësish të siguruar për periudhën 12 muaj nga data e zhvillimit të tenderit,si dhe nuk ka dorëzuar listëpagesat e konfirmuara të punonjësve shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave FDP si dhe urdhër xhirimit në bankë,për periudhën 12 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.
- Nuk figurojnë si drejtues teknik në licencën eshoqërisë si dhe nuk rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për te pakten12(dymbedhjetë) muajt e fundit, si dhe nuk është dorëzuar , kontratë pune të vlefshme, diplomë,CV, libreze pune si dhe *dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të*, për:Inxhinier Elektrik 1(një),Inxhinier Mjedisit1(një),Inxhinier Mekanik1(një), Inxhinier Hidroteknik 1(një), Inxhinier Topograf / Markshejder 1(një).
- Nuk janë dorëzuar listë pagesat e muajit të fundit për të provuar nëse përfshihen në to specialistët e kualifikuar si dhe nuk janë dorëzuar dokumentat kontratën individuale të punës;një dokument (dëshmi kualifikimi profesional /ose deshmite kualifikimit te sigurimit teknik /ose certifikatë te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise), që të vërtetojë kualifikimin profesional, për:2 Teknik Ndertimi (vertetuar me diplome),2 (dy) specialist per montim tubash,1 Elektricitist,1 Suvatues, 1Hidraulik, 1Saldator,1Specialist Ndertimi, 1Karpentier, 1Montator/Hekurkthyes, 1 Mekanik,-1 Bojaxhi.
- Nuk përmbush kriterin për 2 automakinist dhe 2 eskavatorist pasi nuk janë dorëzuar kontrata e punës për 4 manovratorë,pasi kontratat e dorëzuara kanë përfunduar më datë 31.12.2019,nuk janë dorëzuar leje e drejtimit (të vlefshme), Certifikata e Aftesimit Profesional (C.A.P), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Nuk janë dorëzuar deshmi te kualifikimit Teknik (te vlefshme) per MANOVRATORE.
- a. Nuk përmbush kriterin për 1(nje) inxhinier, pjese e drejtuesve Teknik te shoqerise duhet te jete i certifikuar si Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis, 2(dy) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për "*Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne*

*Pune*”, ”Pergjegjes per sigurine”, 2(dy) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit per ”Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier”, ”Pergjegjes per sigurine”, e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, 2(dy) punonjes ne profilin inxhinierik, te cilet duhet te jene te pajisur me certifikaten ”Pergjegjes per Sigurimin e Kontrollit te Cilesise sipas ISO 9001”, e dhene nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, 2(dy) persona te certifikuar per ”Ndhimen e pare dhe nderhyrje ndaj emergjencave”, i cili duhet te figuroje ne listepagese minimalisht per 6 muajt e fundit, 4 (kater) specialist te certifikuar per ”Punime ne lartesi”, te cilet duhet te figurojne ne listepagesat e shoqerise. Detyrimisht te paraqitet kontrate pune dhe certifikata perkatese te tyre.

- Nuk permbush kriterin e percaktuar ne pikat 6,7,8,9 te Kriteve te Kualifikimit si dhe nuk permbush kriterin e percaktuar ne pikën 10 ”Certifikatat e cilësisë), pasi dhe ato certifikata qe ka dorëzuar u ka skaduar afati i vlefshmërsë më datë 16.05.2020 dhe 18.05.2020 para datës së zhvillimit të tenderit.
- Nuk permbush kriterin e percaktuar ne pikën 10 gërmat a,b,c,d,e,f,g,h lidhur me kontratat e furnizimit .
- Nuk ka dorëzuar Planorganizimin dhe Planin e Sigurise ne Kantier si dhe grafikun e punimeve.
- Nuk permbush kriterin per makinerite dhe pajisjet e kerkuara ne pikën 11 te Kriteve te vecanta te kualifikimit. Edhe per ato mjete si kamiona e kamioncina per te cilat ka dorëzuar dokumentacion , te gjithave u ka përfunduar afati I siguracionit dhe certifikata e kontrollit teknik, ne vitin 2019, 2018 apo vitin 2017.

## **2. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë - “Beqiri” sh.p.k& “Shendelli” sh.p.k, për arsyt:**

Nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave konstatohet se ky BOE **nuk** ka dorezuar ne SPE gjithë dokumentat lidhur me kualifikimin tekniko-ligjor te kerkuar ne Kriteret e Pergjithshme dhe te Vecanta te Kualifikimit te pershkruara ne DST, si më poshtë:

- Referuar vërtetimit nr.T02331068 datë 28.05.2020 ,, Për kontributet e sig.shoqërore e shëndetësor ,, dorëzuar nga subjekti „Shëndelli“ shpk ka detyrime në masën 10 485 lekë (104 lekë kamatëvonesa dhe 10 381 lekë gjoba). Nga verifikimet e kryera nga komisioni , sipas vërtetimit nr. T02375264 datë 03.06.2020 , subjekti „Shëndelli“ shpk ka detyrime ndaj organit tatimor në shumën 10 000 lekë (Gjobë lidhur me kontributet). Kjo bie në kundërshtim me nenin 45 gërma „d“ e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kriteret e skualifikimit të operatorëve ekonomikë d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; percaktuar dhe në pikën „d“ të Kriteve të Përgjithshme të Kualifikimit , pasi nuk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.
- BOE nuk ka dorëzuar dokumentacion për 2(dy) inxhinieret pjese e drejtuesve teknike te shoqerise, të pajisur me certifikaten te Trajnimit për ”Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier”, në kundërshtim me pikën 5.2/c të kriteve të vecanta të kualifikimit .
- Në kriteret e kualifikimit pika 5 është kërkuar ”Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te kenë në stafin e tyre punonjesit e meposhtem, te cilet duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën eshoqërisë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme,

diplomë,CV, libreze pune”.Nga verifikimi I liste pagesave rezultoi se A.S ing.ndërtimi pjesë e stafit të drejtuesve teknikë të “Beqiri “ shpk,I deklaruar se do të jetë përgjegjës për zbatimin e punimeve në terren dhe se do të jetë gjithë kohës I pranishëm në object, nuk figuron të jetë në listë pagesat e 12 muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit,figuron të jetë në listëpagesa vetëm muajin e fundit prill 2020,provuar kjo dhe me kontratën e puës e cila është lidhur më datë 20.04.2020.

- Për Inxhinerët S.J,M.B,G.M, pjesë e drejtuesve teknikë të Shëndelli“ shpk nuk është dorëzuar deshmi e kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, në kundërshtim me pikën 5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku kërkohet *”Gjithë drejtuesit teknik duhet te jene te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të”*.
- Për Inxhinerët E.B,V.SH,V.T, pjesë e drejtuesve teknikë të „Shëndelli“ shpk, dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk është dorëzuar e plotë, mungon faqja e dytë e cila përcakton kategorinë e grupit dhe afatin e skadencës, fakt që nuk arrihet të provohet afati i vlefshmërisë së këtyre dëshmime. Kështu që këto dëshmi konsiderohen si të padorëzuara, në kundërshtim me pikën 5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku kërkohet *”Gjithë drejtuesit teknik duhet te jene te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të”*.
- Për Inxhinerët R.I,A.H,E.B,A.S,K.M, pjesë e drejtuesve teknikë të „Beqiri“ shpk, dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik nuk është dorëzuar e plotë, mungon faqja e dytë e cila përcakton kategorinë e grupit dhe afatin e skadencës, fakt që nuk arrihet të provohet afati i vlefshmërisë së këtyre dëshmime. Kështu që këto dëshmi konsiderohen si të padorëzuara, në kundërshtim me pikën 5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit, ku kërkohet *”Gjithë drejtuesit teknik duhet te jene te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të”*.
- Specialisti për montimin e tubave Viktor Baha,pjesë e stafit të „Shëndelli“ shpk nuk figuron ne liste pagesen e shoqerise për muajin e fundit prill 2020, në kundërshtim me pikën 5.1 të kriterëve të vecanta të kualifikimit *”5.1 Operatori ekonomik duhet te deshmojë se pervec stafit teknik te disiplinave te siperpermendura, ne listpagese duhet te rezultojne te punesuar personel teknik te kualifikuar, i domosdoshem per kryerjen e punimeve- 2 (dy) specialist per montim tubash”.Janë dorëzuar dokumentat për dy specialist per montim tubash, njëri prej të cilëve V.B nuk figuron në listë pagesë.*
- Për automakinistin A.K,A.B,B.B dhe eskavatoristët B.B,J.C,P.L pjesë e stafit të Shëndelli „ shpk nuk janë dorëzuar *Certifikata e Aftesimit Profesional (C.A.P)*, lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe për disa mungojnë deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të,e për disa të tjerë mungon faqja e dytë e cila përcakton kategorinë e grupit dhe afatin e skadencës, fakt që nuk arrihet të provohet afati i vlefshmërisë së këtyre dëshmime. Kështu që këto dëshmi konsiderohen si të padorëzuara, në kundërshtim me pikën 5.1 paragrafi fundit të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Për automakinistin E.B dhe eskavatoristët B.I,B.B,I.P dhe S.P pjesë e stafit të „Beqiri“ shpk, nuk janë dorëzuar *Certifikata e Aftesimit Profesional (C.A.P)*, lëshuar nga institucionet përkatëse, si dhe mungojnë deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të,dhe për E.B dhe S.P mungon leja e drejtimit në kundërshtim me pikën 5.1 paragrafi fundit të kriterëve të vecanta të kualifikimit.
- Në krietert e kualifikimit është kërkuar *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater)punonjës manovratorë te mjeteve te renda,nga cilet te jene minimalisht 2 automakinist dhe 2 eskavatorist.Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, lejen e drejtimit (të vlefshme), Deshmine e Aftesise*

*Profesionale D.A.P (te vlefshme), **Certifikata e Aftesimit Profesional (C.A.P)**, lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Keta punojës duhet të jenë të pajisur me **deshmi të kualifikimit Teknik** (te vlefshme) per MANOVRATORE.*

Sa më sipër BOE nuk plotëson kriterin për 2 automakinistë dhe 2 eskavatoristë.

- BOE nuk ka dorëzuar Certifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 3744:2010 (per nivelin e garantuar te fuqise se zerit), e vlefshme.
- OE „Beqiri „ shpk nuk ka dorëzuar licensë III.2.A(1+2) në kundërshtim me pikën 6 të kriterëve të vecanta të kualifikimit në të cilën është kërkuar “6-Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Licence III.2.A(1+2) Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis-Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis. **(Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te jete i pajisur me kete licence.)**
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion për Kontenier, zyra te levizshme, në kundërshtim me pikën 11 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit
- Nuk ka dorëzuar dokumentacion duke mospërmbyllur kriteret për Sistem ëellpoint/ekuivalent per heqje ujrash (shoqeruar dhe me foto)(1 copë),Vinc Karrel (2 copë),Skarifikues Asfalti( 1 copë)

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **informojmë** Bashkimin e Operatorëve ekonomikë - “Viante Konstruksion”sh.p.k &”Euro-Alb” sh.p.k, me adresë: Lagjia “Sporti “, Gramsh & “ Lagjia “Minatori”,rruga e Spitalit,Pall.nr.22,shk.1,kati 5,Ap.15, Bulqizë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 29 785 889 (njëzetë e nëntë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e pesëmijë e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë )lekë,pa TVSH,është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “**Ujësjetllës Gramsh”sh.a,pranë Degës ekonomike**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj(nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [...], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.06.2020

Ankesa:**Nuk ka pasur ankesa .**

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**  
**ADMINISTRATORI**  
**TAJAR BICI**